



01Nr.104/02-19963/22
Kačanik, 02.09.2022

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 18, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2019), të nenit 18 të Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës Kačanik në mbledhjen e datës 02 Shtator 2022 merr :

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE PËR PROCEDURAT E
DHËNIES NË SHFRYTEZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim formohet komisioni i ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në përbërje prej 5 anëtarëve; prej tyre dy (2) anëtarë propozohen nga Kryetari i Komunës nga radhët e ekzekutivit të Komunës, dy (2) anëtarë propozohen nga Kuvendi i Komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile.
2. Komisioni si në pikën 1 të këtij Vendimi, ka këtë përbërje:
 1. Zekir Selimi - anëtar (Ekzekutivi)
 2. Fadil Guri - anëtar (Ekzekutivi)
 3. Brahim Imishti - anëtar (Kuvendi)
 4. Adnan Reka- anëtar (Kuvendi)
 5. Naim Hysa - anëtar (Shoqëria Civile).
3. Komisioni i ankesave shqyrton ankesat brenda dhjetë (10) ditësh dhe nëse konstaton se ka pas shkelje gjatë procesit të vlerësimit, kërkon rishqyrtimin e ofertave.
3.1 Nëse komisioni i ankesave vlerëson ankesat si të pabazuara, raporti i vlerësimit së bashku me ofertën e përzgjedhur i dërgohet kuvendit të komunës për miratim.
4. Mandati i Komisionit të ankesave është 2 vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit të ankesave, Kryetari i komunës, Drejtoria e Urbanizmit ,Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli